

## SHEFKIJE ISLAMAJ

### ROBERT ELSIE DHE GJUHA SHQIPE

Në një intervistë të zhvilluar më 2008 e të botuar në gazetën “*Shqip*”<sup>1</sup>, pyetjes së bashkëbisedueses se “shumë lexues do të ishin kuriozë të dinin si ndodhi që një anglez si ju, të bëhej një nga përkthyesit më të njohur të shqipes”<sup>2</sup>, Robert Elsie i përgjigjet: “Nuk e mendoja kurrë që shqipja do të bëhej pasioni im”. Megjithëse nëntë vite para se të ndahej nga jeta kishte pohuar kështu, Robert Elsie i ishte drejtuar herët Shqipërisë, me kureshtjen e një të posadiplomuari të shkëlqyer, me dëshirën e një të riu për të vëzhguar e për të gjurmuar dhe me pasionin e një studiuesi që ngarend pas së panjohurës.

Kur Robert Elsie erdhi për herë të parë në Shqipëri, më 1978<sup>3</sup>, për qëllime studimore, ai ishte asokohe 28-vjeçar dhe e dinte gjuhën shqipe, e kishte mësuar në mënyrë autodidakte. Ky vit mund të quhet si viti i fillimit të lidhjes së tij të përjetshme me shqiptarët, me gjuhën shqipe, me letërsinë, me historinë, me kulturën shqiptare. Ata që e kanë njohur asokohe thonë se që atëherë ai “fliste shqip me një fjalor jo shumë të pasur, por i shqiptonte shumë saktë të gjitha zanoret e bashkëtingëlloret e gjuhës sonë dhe nuk mund ta dalloje se cila ishte gjuha e tij amtare”<sup>4</sup>. Ai njihte mirë, pos gjuhës se tij amtare, gjermanishtes, edhe gjuhë të tjera, si anglishten, frëngjishten, keltishten, italishten, serbishten etj.

Nga ajo kohë e deri në tetor të këtij viti, kur Robert Elsie u nda nga kjo jetë, janë mbushur pothuajse 40 vjet. Këta 40 vjet Robert Elsie i ka mbushur me shumë përkushtim, zell, punë, pasion, mbi të gjitha me shumë dashuri për shqiptarët, për gjuhën e kulturën e tyre, për të shkruarën e të tashmen e tyre. Këtë më së miri e dëshmojnë veprat e tij të botuara në gjuhën shqipe, por më të shumtat në gjuhë të huaja, para së gjithash në anglishten; këtë e dëshmon një numër i madh studimesh, trajtesash, vështrimesh e artikujsh të botuar për çështje të ndryshme që lidhen me gjuhën shqipe, me letërsinë e shkruar e

---

<sup>1</sup> Robert Elsie: *Nuk e mendoja kurrë që shqipja do të bëhej pasioni im*, intervistë e zhvilluar me Alda Bardhylin, gazeta “*Shqip*”, Tiranë, 2008.

<sup>2</sup> Përcaktimin e gazetares “anglez” për Robert Elsie-n e konsideroj shkarje rasti.

<sup>3</sup> Data 1978 e ardhjes së tij për herë parë në Shqipëri si dhe detaje të tjera biografike vetë Robert Elsie i ka dhënë në intervistat e tij të shumta.

<sup>4</sup> Th. Gjika, *Përbushet amaneti, Robert Elsie prehet në Theth me kostum popullor*, gazeta “*Panorama*”, Tiranë, 17.10.2017.

letërsinë gojore, me etnografinë, antropologjinë e mitologjinë, me figura e personalitete të botës shqiptare e të huaj, që janë marrë me gjuhën, me historinë dhe me kulturën shqiptare; e dëshmojnë gjurmimet e zbulimet për të kaluarën e jetës shpirtërore e materiale të shqiptarëve. Gjuha shqipe e kultura shqiptare, e them me siguri të plotë, nuk kanë pasur misionar më të mirë për t'ia paraqitur botës me aq përkushtim e me aq vërtetësi.

Që nga vepra e tij a parë, "Fjalori i letërsisë shqipe (*Dictionary of Albanian literature*)", më 1986, e deri te vepra e tij e fundit, "Alfabetet e shqipes: të huazuar dhe të krijuar", më 2017, ai botoi më se 60 vepra fushash të ndryshme filologjike, përkatësisht albanologjike. Ndër këto vepra, më të shumtat janë nga fusha e letërsisë, e letërsisë gojore, e antropologjisë, e historisë dhe e kulturës shqiptare, por interesimi i tij nuk ka munguar as për gjuhën shqipe e dialektet e saj dhe as për historinë e të tashmen e saj. Edhe pse numri i shkrimeve të tij me karakter gjuhësor nuk është i madh, ato shquajnë si nga temat e trajtuara, ashtu edhe nga shumësia e të dhënave të reja që sjellin. Ato janë botuar kryesisht në periodikun shkencor në Londër, Nju Jork, Berlin, Mynih, Gëtingen, Birmingen, por edhe në Tiranë, Prishtinë e gjetiu.

Mund të thuhet se në të shumtën e herës trajtesat e tij me tematikë gjuhësore kanë karakter kritik, zbulues, shpjegues e problematizues. Këto shkrime shquhen për veçanësinë dhe origjinalitetin e tyre dhe, sidomos, për argumentimin bindës, të saktë e të pasur me të dhëna të nevojshme dëshmuuese. Shquajmë ndër to shkrimet: "Dorëshkrimi Elbasanas i Ungjijve 1761 dhe lufta për krijimin e një alfabeti shqiptar"<sup>5</sup>; "Letërsia shqipe në dorëshkrimet greke: tradita ortodokse në shekullin tetëmbëdhjetë dhe në fillim të shekullit nëntëmbëdhjetë në shkrimet shqipe"<sup>6</sup>; "Një vjedhje në Dubrovnik dhe dalja në skenë e gjuhës dhe e kulturës shqiptare"<sup>7</sup>; "Të dhëna të hershme të ekzistencës së gjuhës shqipe"<sup>8</sup>; "Leksiku shqip i Evlija Çelebiut i vitit 1662 dhe ç'duhet të dijë dervishi shtegtar"<sup>9</sup>; "Teksti i Bellifortisit dhe shqipja e hershme"<sup>10</sup> (botuar

<sup>5</sup> *Dorëshkrimi elbasanas i ungjijve 1761 dhe lufta për krijimin e një alfabeti shqiptar*, "Studime" 1, Prishtinë, 1994, f. 125-139.

<sup>6</sup> *Albanian literature in Greek script. The eighteenth and early nineteenth century Orthodox tradition in Albanian writing*, "Byzantine and Modern Greek Studies" 15, Birmingem, 1991, f. 20-34.

<sup>7</sup> *Një vjedhje në Dubrovnik dhe dalja në skenë e gjuhës dhe e kulturës shqiptare*, "Përpyekja" 6, Tiranë, 1996, f. 88-92; "Rilindja", Prishtinë, 26.7.1999, f. 9.

<sup>8</sup> *Të dhëna të hershme për ekzistencën e gjuhës shqipe*, "Tempulli" 2; Korçë, 2000, f. 19-24.

<sup>9</sup> *Leksiku shqip i Evlija Çelebiut i vitit 1662 dhe ç'duhet të dijë dervishi shtegtar*, "Studime" 4, Prishtinë, 1997, f. 239-249 (përkthyer nga Rexhep Ismajli); botuar së pari në gjuhën gjermane: *Südost-Forschungen*, München, 57 (1998), S. 95-102; dhe në "Bota shqiptare" 67, Romë, gusht, 2002, f. 10-11.

së pari në gjuhën gjermane); “*Fjalorthi i Arnold Von Harfit 1497*”<sup>11</sup>; “*Fati i Gjon Buzukut*”<sup>12</sup>, “*Dendronymica albanica. Vështrim mbi emrat shqip të drurëve dhe shkurreve*”<sup>13</sup> etj.

Ndër më të rëndësishmen konsideroj trajtesën “*Dorëshkrimi Elbasanas i Ungjijve 1761 dhe lufta për krijimin e një alfabeti shqiptar*”. Robert Elsie, mbështetur në referenca të shumta shkencore nga autorë shqiptarë e të huaj, paraqet një historik përmbledhës e një përshkrim të shkurtër të alfabeve të shqipes, të hartuara e të përdorura brenda 100 vjetëve (1750-1850), të vështruara në raport me kontekstin kohor dhe hapësinor, duke e përqendruar vëmendjen te “*Dorëshkrimi Elbasanas i Ungjijve*” (1761) dhe te disa mëdyshje lidhur me autorësinë dhe datimin e tij.

Kjo trajtesë mund të vlerësohet jo vetëm për karakterin njohës e paraqitës për publikun joshqiptar, por edhe për karakterin ndriçues e zbulues. Në të vërtetë është një sprovë që synon të ndriçojë me të dhëna e interpretime të reja alfabetet e krijuara e të përdorura brenda një periudhe shekullore të historisë sonë shkrimore, një periudhe kombëtare që shënon qartë përpjekjet e ndërgegjegjshme të intelektualëve të paktë shqiptarë të kohës për të zgjidhur problemin e mungesës së një alfabeti të përbashkët jo vetëm për shkrimet liturgjike e të tjera, por edhe për krijimin e një letërsie shqipe, në një kohë kur popujt fqinjë tashmë “kishin alfabetet e veta që ndihmuan në zhvillimin e shpejtë dhe në afirmimin e kulturave dhe të letërsive përkatëse”<sup>14</sup>. Në të mirë të këtij konstatimi e shohim të udhës të sjellim edhe mendimin e Xhevat Lloshit se “deri në këtë kohë përpjekjet për shkrimin e shqipes kishin më tepër qëllime jashtëgjuhësore, ndër të cilat me rol të veçantë ka qenë synimi për të mbështetur shërbesat fetare shqip”<sup>15</sup>, dhe më tej se “tashmë zgjerohet qëllimi për t’i shërbyer gjuhës shqipe në vetvete, për ta ngulitur atë si gjuhë të

<sup>10</sup> R. Elsie, *The Bellifortis text and early Albania*, Zeitschrift für Balkanologie, Berlin, 22.2.1986, f. 158-162.

<sup>11</sup> *The Albanian lexicon of Arnold von Harff, 1497*, “Zeitschrift für Vergleichende Sprachforschung” 97, Göttingen, 1984, f. 113-122.

<sup>12</sup> Botuar në: Demiraj, Bardhyl (ed.): *Nach 450 Jahren. Buzukus “Missale” und seine Rezeption in unserer Zeit*. 2. Deutsch-Albanische kulturwissenschaftliche Tagung in München vom 14. Dhe 15. Oktober 2005. Albanische Forschungen, 25. ISBN 978-3-447-05468-3; Harrassowitz, Wiesbaden 2007, f. 211-215; *Fati i Gjon Buzukut, gazeta*,”*Shekulli*”, Tirana, 14.6.2006, f. 18-19.

<sup>13</sup> R. Elsie, *Dendronymica albanica. Vështrim mbi emrat shqip të drurëve dhe shkurreve*, “*Studime*” 3, ASHAK, Prishtinë, 1996, f. 275-318.

<sup>14</sup> R. Elsie, “*Dorëshkrimi Elbasanas i Ungjijve 1761 dhe lufta për krijimin e një alfabeti shqiptar*”, “*Studime*” 1, Prishtinë, 1994, f. 125-139.

<sup>15</sup> Xh. Lloshi, *Rreth alfabetit të shqipes*, “*Logos*”, Shkup, 2008, f. 103.

shkruar”<sup>16</sup>, për çka, si thotë ai në vazhdim, duhen përgatitur mjetet – alfabeti, gramatikat dhe fjalorët.

Mungesa e “pajtimit kombëtar” mbi çështjen e një alfabeti sadopak të njësuar ka sjellë, sipas Robert Elsie-t, prapangelje në zhvillimin e letërsisë shqipe. Duke qenë se kemi të bëjmë me një kontekst kohor, hapësinor e fetar mjaft të ndërlikuar, është fare e pritshme që përdorimi i alfabeve ekzistuese “tregonte një identifikim të qartë me një fe dhe me një kulturë të huaj, një identifikim të papranueshëm për shqiptarët e besimeve të tjera”<sup>17</sup>. Në veri të Shqipërisë shqiptarët katolikë përdornin alfabetin latin, në jug shqiptarët ortodoksë alfabetin grek, kurse shqiptarët myslimanë parapëlqenin alfabetin arab, atë të *Kur’anit*. Në një gjendje të tillë, sipas autorit të shkrimit, është fare e qartë se duhet të ketë ekzistuar një dëshirë tek intelektualët shqiptarë që populli shqiptar “të ketë një alfabet të vetin, dhe nuk është e rastit që kjo dëshirë për një alfabet origjinal shqiptar ishte më e theksuar në Shqipërinë e Mesme”<sup>18</sup>.

Siç na mëson historia jonë kulturore, kjo periudhë njihet si mjaft konfuze e ndarëse sa i përket përdorimit të alfabeve të shumta e burimesh të ndryshme, në rend të parë në shkrimet fetare. Në të vërtetë, siç e thotë edhe studiuesi Xhevat Loshi, pikërisht këtu gjejmë “zanafillën e luftës për alfabetin e shqipes”<sup>19</sup>. Sipas Robert Elsie-t, ishin shqiptarët e krishterë të Shqipërisë së Mesme që do të bënin “përpjekjen e parë për krijimin e një alfabeti origjinal, dhe pikërisht nga ana e tyre u krijuan alfabetet e para origjinale në periudhën 1750-1850”<sup>20</sup>. Ndër këto alfabete, sipas tij, shquan alfabeti i *Dorëshkrimit Elbasanas të Ungjijve* (1761), i njohur si Anonimi i Elbasanit, një “dorëshkrim i vogël prej 30 fletësh që përmban tekste biblike, që ruhet në Arkivin e Shtetit në Tiranë”<sup>21</sup>, i cili konsiderohet me rëndësi historike dhe si “një përpjekje e pashoqe për ta zgjidhur problemin e alfabetit”<sup>22</sup>. Ky dorëshkrim, duke përjashtuar tekstin e shkurtër të Ungjillit të Pashkëve të shekullit pesëmbëdhjetë, konsiderohet “vepra më e vjetër e letërsisë ortodokse shqiptare dhe në të njëjtën kohë përkthimi i parë ortodoks i Biblës”<sup>23</sup>.

Siç u pa, Robert Elsie, alfabetin e *Dorëshkrimit Elbasanas të Ungjijve* e quan alfabetin më të hershëm origjinal të shqipes. Në përshkrimin që i bën, ky

<sup>16</sup> *Po aty*, f. 103.

<sup>17</sup> R. Elsie, *Dorëshkrimi Elbasanas i Ungjijve 1761 dhe lufta për krijimin e një alfabeti shqiptar*, f. 125-139.

<sup>18</sup> *Po aty*, f. 125-139.

<sup>19</sup> Xh. Lloshi, *po aty*, f. 105.

<sup>20</sup> R. Elsie, *po aty*, f. 125-139.

<sup>21</sup> *Po aty*, f. 125-139.

<sup>22</sup> *Po aty*, f. 125-139.

<sup>23</sup> *Po aty*, f. 125-139.

dorëshkrim ka 59 faqe të përkthimeve biblike që përmbajnë 6.113 fjalë të shkruara në një alfabet prej 40 germash, nga të cilat 35 janë germa të zakonshme dhe 5 germa të rralla. Me dallim nga Dhimitër Shuteriqi dhe Domi të cilët, sipas Elsie-t “ngulin këmbë për një ndikim sllav të fortë në krijimin e këtij alfabetit, gjë që shpjegohet, sipas atyre, në varësinë, deri në vitin 1767, e kishës orthodokse në Shqipëri nga Partriarhati Bullgar i Ohrit”<sup>24</sup>, ky i fundit shpreh mendimin se “megjithëse disa germa të kujtojnë alfabetin grek, shumica e germave të këtij alfabetit duket të jenë krijime të reja pa ndikim të gjuhëve dhe të alfabeve të popujve fqinjë”<sup>25</sup>.

Vlen të silllet këtu edhe mendimi tjetër i tij, ndonëse mund të jetë i diskutueshëm, se alfabeti i *Dorëshkrimit Elbasanas të Ungjijve* i përshtatet mirë gjuhës shqipe, madje, se ai “i përshtatet më mirë se alfabeti shqip i sotëm”, sepse, siç thotë Elsie, alfabeti i Elbasanit, me pak përjashtime, përdor “një germë për çdo fonemë” dhe se, në përgjithësi, sistemi grafik i tij është i qartë dhe i mirëkonceptuar nga krijuesi i tij. Me mjaft të dhëna, ai, përpiket të përcaktojë autorin dhe datimin e këtij alfabeti. Te supozimeve që shoqërojnë shkrimet e shumta mbi këtë alfabet dhe mbi autorin e tij, Robert Elsie shpreh edhe mendimin se “të dhënat historike dhe gjuhësore që kemi në dispozicion, na sjellin përfundimin se autori i tij quhej Gregori i Durrësit (greqisht: Grêgorios ho Dyrrakhíu), i njohur gjithashtu si Gregori i Voskopojës”<sup>26</sup>, ndryshe nga mendimi i Dhimitër Shuteriqit, i cili, sipas Elsiet, “në përpjekjen e tij për ta deshifruar tekstin në kapakun e dorëshkrimit me alfabetin tjetër të lartpërmendur, lexon emrat Theodoros Bogomilos dhe Papa Totasi”<sup>27</sup>. Këta dy emra i gjejmë edhe në historinë e letërsisë shqipe<sup>28</sup>. Robert Elsie e pranon se për të dyja këto hipoteza nuk ka të dhëna të mjaftueshme në të mirë të tyre. Po të pranohen të dhënat që sjell ai mbi autorësinë e Gregorit të Durrësit dhe mbi saktësinë e të dhënave të tjera të kësaj kohe e më pas, del se *Dorëshkrimi Elbasanas* mban pikërisht vitin 1761. Sipas Elsie-t, ky dorëshkrim paraqet një përpjekje fillestare për një përkthim më të gjerë të Biblës. Lejohet të mendohet se ky dorëshkrim mund të ketë moshë më të madhe, qoftë pse nuk ekzistojnë të dhëna kundërshtuese për datimin e supozuar të tij, qoftë pse nuk është zbuluar një tjetër i tillë.

Robert Elsie shtron edhe “mëdyshje” të tjera lidhur me këtë dorëshkrim, ndër to edhe çështjen e dialektit a të nëndialektit në të cilin u shkrua ky dorëshkrim; për këtë ai thotë se “përkthimet janë bërë në një dialekt gegë jugor,

<sup>24</sup> *Po aty*, f. 125-139.

<sup>25</sup> *Po aty*, f. 125-139.

<sup>26</sup> *Po aty*, f. 125-139.

<sup>27</sup> *Po aty*, f. 125-139.

<sup>28</sup> *Historia e letërsisë shqipe*, grup autorësh nën drejtimin e Dhimitër Shuteriqit, Rilindja, Prishtinë, 1989, f. 54-55.

si dialekti i Elbasanit, por përmbajnë edhe disa elemente të toskërishtes që nuk ekzistojnë në dialektin e sotëm të Elbasanit”, çka lejon të mendohet për përzjerje dialektesh.

Një tjetër çështje, së cilës autori i kushton vëmendje në këtë trajtesë, është ajo që lidhet me faktin se ky dorëshkrim ka fare pak fjalë të huaja. Mungesa e fjalëve të huaja (ka vetëm tri fjalë latine e shtatë fjalë turke), sipas Elsie-t, dëshmon se autori i këtij dorëshkrimi “nuk pranonte islamizimin e plotë të vendit dhe në anën tjetër se donte të përdorte një gjuhë të pastër në alfabetin e tij origjinal”<sup>29</sup>.

Shkrimi parashtron edhe hipoteza të tjera jo vetëm lidhur me këtë alfabet, por edhe për alfabetet e tjera që shqyrtohen këtu. Kështu, autori jep hollësi të dëshmuara me referenca të mjaftueshme shkencore të autorëve që janë marrë me historinë e shkrimit shqip, përkatësisht me historinë e alfabeve të shqipes, si Johan Georg von Han, Leopold Geitler, Rajko Nahtigal, Zabiras, Gaetano Petrota, Injac Zamputi, Ilo Mitkë Qafëzezi, Gjergj Pekmezi, Lef Nosi, Namik Resuli, Justin Rrota, Dhimitër Shuteriqi, Mahir Domi, Ziaudin Kodra, Stavro Skendi, Petro Janura, Tomor Osmani, Rexhep Qosja, Titos Johalas, Armin Hetzer, Mahmut Hysa etj., për alfabetin e *Dorëshkrimit Elbasanas*, si edhe për alfabetet e tjera të rëndësishme pas tij, siç janë ai i Todhri Haxhifilipit, i Kodeksit të Beratit, i Gjirokastritit, i Jan Vellarait dhe alfabeti i Naum Veqilharxhit, si i fundit i kësaj periudhe. Sipas Robert Elsie-t në këtë periudhë 100-vjeçare (1750-1850) gjuha shqipe u shkrua me dhjetë alfabete: shtatë nga ato alfabetet origjinale të lartpërmendura dhe tri sosh adaptime të alfabeveve latin, grek dhe arab. Mendoj se gjurmimi i këmbëngulët i Robert Elsie-t pas historikut të alfabeve të shqipes nga koha kur u botua kjo trajtesë më 1994 nuk ka pushuar deri në vitin prill 2017, kur botoi librin “*Alfabetet shqipe: të huazuar dhe të krijuar*”, pak kohë para se ai të ndahej nga jeta.

Edhe shkrimi tjetër i Robert Elsie-t, i titulluar “*Letërsia shqipe në dorëshkrimet greke: tradita ortodokse në shekullin tetëmbëdhjetë dhe në fillim të shekullit nëntëmbëdhjetë në shkrimet shqipe*”<sup>30</sup>, trajton çështje të historisë shkrimore, përkatësisht të historisë gjuhësore të shqipes në shekullin 18 e në fillim të shekullit 19, domethënë në kohën kur tokat shqiptare ishin nën pushtimin otoman, por kur bëheshin edhe përpjekje të pareshtura për të ringjallur, përmes klerit ortodoks, ide, mendësi, zakone, përkatësisht për të ringjallur *Bizantizmin* tashmë të venitur. Duke qenë se shkrimi i sillel kohës së

<sup>29</sup> R. Elsie, *Dorëshkrimi Elbasanas i Ungjijve 1761 dhe lufta për krijimin e një alfabeti shqiptar*, f. 125-139.

<sup>30</sup> Kjo trajtesë është botuar si kapitull më vete me po këtë titull edhe brenda veprës së Robert Elsie-t *Histori e letërsisë shqiptare*, “Dukagjini”, Pejë, 2001, f. 89-103; edhe në botimin anglisht *History of Albanian Literature*, Boulder, Colorado 1995, në dy vëllime.

njëjtë dhe tematikës së përafërme me atë të trajtesës së paraqitur më lart, mjaft të dhëna e hollësi që lidhen me alfabetet e kësaj kohe e me autorët e tyre i gjejmë të shqyrtuara edhe këtu. Ky shkrim, po kështu argumentueshëm, përmes referencave shkencore për këtë periudhë të historisë sonë letrare-gjuhësore, trajton në mënyrë kronologjike dorëshkrimet me alfabetë mbi bazën greke, duke zgjeruar rrethin e autorëve të kësaj periudhe të rëndësishme për historinë e shqipes, autorë tekstesh fetare, përkthyes të Dhiatës së Re, që ishin në radhë të parë autorë gramatikash e fjalorësh, autorë shkrimesh letrare etj., siç janë Konstantin Cepi, Vangjel Meksi, Konstantin Kristoforidhi, Teodor Kavalioti, Marko Boçari, Jani Evstrat Vithkuçari, Nikolla Ikonon Postenani dhe i vëllai i tij Stefan Postenani, Jan Vellarai etj. Shkrimi, pos të dhënave që njiheshin tashmë në historinë tonë gjuhësore e letrare, sjell edhe mjaft të dhëna të reja, të diskutueshme e të panjohura, nga hulumtimet e tij në biblioteka të njohura.

Një shkrim tjetër i Robert Elsie-t kushtuar lashtësisë së shqiptarëve dhe gjuhës shqipe është “*Një vjedhje në Dubrovnik dhe dalja në skenë e gjuhës dhe kulturës shqiptare*”. Shkrimi është i shkurtër, por në të autori, pa dashur të prekë, siç e thotë vetë, “sensibilitetin e Ballkanit” kur shtrohet çështja e lashtësisë së popujve që e përbëjnë atë, duke mos parapëlqyer këtu e në këtë kontekst fjalën *lashtësi* dhe as të rimarrë për trajtim teoritë e ndryshme të prejardhjes së shqiptarëve, sjell fakte konkrete se në çfarë periudhe dolën shqiptarët si komunitet gjuhësor në skenë nga mjegulla e historisë. Për të provuar diçka më shumë në këtë drejtim nga ajo që shkruhet në shumicën e teksteve për historinë e shqiptarëve, ai vlerëson katër fakte të argumentuara me të dhëna njohëse nga literatura shkencore përkatëse. Kështu, për të provuar mendimin e tij se shqiptarët “hynë në skenë të historisë së shkruar pasklasike në gjysmën e dytë të shekullit njëmbëdhjetë dhe se vetëm në këtë shekull mund të flasim me siguri mbi një popull shqiptar siç e njohim sot”<sup>31</sup>, ai sjell si dëshmi të parë historianin bizantin Mihal Ataliates, i cili në *Historinë* e tij të shkruar në vitet 1079-1080, flet për fisin *Albanoi* si pjesëmarrës të një kryengritjeje kundër Konstantinopolit në vitin 1043, si dhe për *Arbanitai-t* si një popull i princit të Durrësit, dhe si dëshmi të dytë historianin tjetër bizantin, Gjon Skilica, i cili flet për *Arbanites* si ushtarë në trupat e mbledhur në Durrës nga Nikeforos Basilakios. Pra, pos të dhënave të Ptolemeut nga periudha romake, që janë të mbarënjohura, këto janë dy raste të tjera ku gjejmë të shkruar emrat *Alban- e Arban-*. Nga kjo periudhë, mendon Robert Elsie, populli shqiptar fillon të marrë një fizionomi e identitet, edhe përballë popujve të tjerë.

Ndërkaq, Robert Elsie na sjell në vëmendje dokumentet e njohura mesjetare, sipas të cilave ekzistenca e gjuhës shqipe përmendet për herë të parë në fund të shekullit trembëdhjetë dhe në fillim të shekullit katërmëdhjetë,

---

<sup>31</sup> *Një vjedhje në Dubrovnik dhe dalja në skenë e gjuhës dhe e kulturës shqiptare*, “Përpjekja” 6, Tiranë, 1996, f. 88-92; “Rilindja”, Prishtinë, 26.7.1999, f. 9.

madje gjatë viteve 1285-1332 përmendet katër herë. Rasti i parë është ai i vitit 1285, i dëshmuar në krahinën e Dubrovnikut ose të Raguzës, asokohe e populluar edhe me mjaft shqiptarë. Siç na e thotë ai, në hetimet që do të zhvillohen për një vjedhje në shtëpinë e Petro del Volcio nga Belena, biri i Markut prej Mençe, njëfarë Matheus, me gjasë dëshmitar i këtij delikti, raportoi kështu latinisht: “Audiui unam vocem clamantem in monte in lingua albanesca” (“Dëgjova një zë duke thirrur në malësi në gjuhën albaneske”)<sup>32</sup>.

Ky rast dhe tri rastet e tjera, për të cilat Robert Elsie flet hollësisht duke i dëshmuar me referencat e nevojshme faktike, ndodhin brenda 47 vjetëve dhe ato lidhen: i dyti, me dëshmi që gjejmë në një përskrim udhëtimi nga një anonim (1308), i treti, me dëshmi që dalin në një vepër të një shtegtari drejt Tokës së Shenjtë (1322) dhe rasti i katërt, i fundit, nga një vepër e një murgu frëng i urdhrorit dominikan me emrin Brokard (1332), ku gjendet fjalia në gjuhën latine “Shqiptarët kanë një gjuhë tjetër krejt ndryshe nga latinishtja, megjithatë përdorin shkronja latine në të gjithë librat e tyre”<sup>33</sup>, fjali kjo e përfshirë nga historianët tanë gjuhësorë në librat tanë mbi gjuhën shqipe për të dëshmuar ekzistencën e librave shqip asokohe e për të cilën Robert Elsie mendon se ka shumë të ngjarë që Brokardi “e kishte fjalën për gjuhën latine të përdorur në Shqipëri”<sup>34</sup>. Pavarësisht kësaj, Robert Elsie mendon që këto dëshmi provojnë se shqiptarët në këtë kohë për herë të parë “kishin dalë përfundimisht në skenë si popull me një gjuhë dhe me zakonet e veta”<sup>35</sup>, domethënë 120 vjet para se të dilte dokumenti i parë i shkruar në gjuhën shqipe më 1405 dhe dokumentet e tjera të njohura përgjatë shekullit 15 (1462, 1483, 1497) shqiptarët ishin shquar si popull me identitet historik gjuhësor dhe zakonor.

Shkrimi “*Të dhëna të hershme të ekzistencës së gjuhës shqipe*” i Robert Elsie-t është ndërtuar mbi të dhënat që ofrojnë dëshmitë e hershme për gjuhën shqipe, kryesisht mbi të dhëna të viteve 1285-1322, që i gjejmë të trajtuara edhe në shkrimin “*Një vjedhje në Dubrovnik dhe dalja në skenë e gjuhës dhe kulturës shqiptare*”, vetëm se këtu, këto të dhëna, autori i shfrytëzon për të sjellë disa përfundime me interes për rëndësinë e këtyre të dhënave, ndër të cilat shquajmë këto: 1. Gjuha shqipe “ishite rrënjosur mirë në brigjet juglindore të Adriatikut, aq sa të shquhej nga vëzhguesit e huaj që zbarkonin në portet bregdetare të Durrësit dhe të Dubrovnikut”<sup>36</sup>; 2. gjuha shqipe “duhet të jetë folur gjerësisht në rrafshinat bregdetare dhe rajonet majore në këtë kohë”<sup>37</sup>; 3.

<sup>32</sup> R. Elsie, *po aty*, f. 88-92.

<sup>33</sup> *Po aty*, f. 88-92.

<sup>34</sup> *Po aty*, f. 88-92.

<sup>35</sup> *Po aty*, f. 88-92.

<sup>36</sup> R. Elsie, *Të dhëna të hershme për ekzistencën e gjuhës shqipe*, “Tempulli” 2, Korçë, 2000, f. 19-24.

<sup>37</sup> *Po aty*, f. 19-24.

datimi i këtyre të dhënave dëshmuese për gjuhën shqipe dhe për shqiptarët brenda një periudhe më pak se 50-vjeçare “nuk duhet të konsiderohen si tregues që shqipja apo format e hershme të saj nuk flitëshin në shekujt paraardhës”<sup>38</sup>; 4. në qoftë se shqiptarët, siç na e dëshmon edhe *Përshkrimi Anonim*, “ishin nomadë të zonave fshatare dhe në qoftë se ngulimet e tyre ishin më të përqendruara në malësi sesa në zona bregdetare, ka shumë të ngjarë që ata thjesht lireshin jashtë vëmendjes, edhe sikur të kishin krijuar një grup etnik të vërtetë”<sup>39</sup>. Mendoj se këto përfundime janë bazë e mirë për studiuesit e fushës për të çuar më tej hamendësimet interesante të Robert Elsie-t.

Në shkrimin me titull “*Leksiku shqip i Evlija Çelebiut i vitit 1662 dhe ç’duhet të dijë dervishi shtegtar*”, Robert Elsie merr në shqyrtim një *Fjalorth të shqipes* të Evlija Çelebiut (pseudonimi i Mehmet Zili ibn Dervishit 1611-1684), një shkrimtari të talentuar turk, një udhëpërshkruesi që ka lënë pas vetes 19 vëllime (nga të cilat në gjuhën turke janë botuar 10 sish), të shkruara a të diktuar pas udhëtimeve të tij të shumta përgjatë gjithë Perandorisë, dorëshkrimet e të cilit gjenden në shumë biblioteka (Stamboll, Vjenë, Londër, Mynih, Bazel, Mançester etj.). Pjesë të këtyre dorëshkrimeve janë përkthyer në disa gjuhë, edhe në shqipen, dhe janë burim tejet i pasur me informata jo vetëm për Ballkanin e popujt e tij, por edhe për shumë më gjerë.

Libri i udhëtimeve i Evlija Çelebiut nëpër toka të populluara asokohe me shqiptarë, gjatë viteve 1660, 1662, 1670, në pjesën më të madhe të qyteteve të asokohshme të Shqipërisë Veriore e Jugore, të Maqedonisë, të Kosovës, të Malit të Zi, përmban shumë informata për gjeografinë, historinë tonë kulturore të shekullit shtatëmbëdhjetë, përfshirë edhe folklorin dhe, sidomos, për jetën e brendshme të vendeve që kishte vizituar ai tri herë gjatë jetës së tij. Robert Elsie gjykon që ky libër përbën një minierë të vërtetë informatash dhe ka vlerë të paçmueshme për një periudhë, ta quajmë, të errët për historiografinë tonë.

*Fjalorthi shqip* i Evlija Çelebiut është një ndihmesë e dobishme për historinë gjuhësore e kulturore shqipe, me moshë dy shekuj më i vonë se *Formula e Pagëzimit* e Pal Engjëllit (1462). Fjala është për një fjalor “unikal”, siç thotë autori, për jetën e përditshme në Shqipërinë e shekullit shtatëmbëdhjetë, i hartuar gjatë qëndrimit të tij në Shkodër a Bushat, në vitin 1662, që ofron, si thotë ai, çka duhet të dijë një dervish derisa udhëton në tokat e “të pabesëve”, që në pjesën më të madhe mendohet se është shënuar me saktësi. Ndonëse nga udhëtimet e tij ai jep tridhjetë e një lloj gjuhësh jo turke dhe së paku po aq gjuhësh turke e dialektesh, sipas tij dhe studiuesve të tjerë që janë marrë me udhëpërshkrimet e tij, ai lavdërohet për “imagjinatën e tij në mbarështrimin e rrjedhojave të fjalëve dhe për aftësinë e tij si etimologjizues i

<sup>38</sup> *Po aty*, f. 19-24.

<sup>39</sup> *Po aty*, f. 19-24.

pakorrigjueshëm”<sup>40</sup>. *Fjalori* përmban fjalë e shprehje të përditshme që mund t’i hyjnë në punë dikujt në vend të huaj, pastaj numërorë, përshëndetje, mallkime, sharje, thirrmore etj. Në këtë shkrim autori bën përpjekje të analizojë njësitë leksikore dhe shprehjet e këtij fjalori duke sjellë edhe një të dhënë të re se në këtë fjalorth paraqiten për herë të parë sharjet në gjuhën shqipe, për dallim nga mallkimet të cilat kanë një datë më të hershme. Sipas Robert Elsie-t, “nama më e hershme shënuar shqip *Dramburi te clofto gogle* (e trëmburi të qoftë goja) vjen nga viti 1483 dhe u zbulua në pjesën latinisht të Renesansës Epirota të Tommaso de Mezzo”<sup>41</sup>, për të vazhduar më tej me konstatimin se shënime të sharjeve, të ekspletivëve të tjerë shqip, si i quan ai, kemi pak deri në shekullin njëzet. Këtu vlen të përmendet se Robert Elsie, bashkë me profesorin e Universitetit të Çikagos, Robert Dankof, ka përkthyer nga osmanishtja pjesë nga “*Libri i udhëtimeve*” të Evlija Çelebiut, i quajtur në gjuhën turke “*Sejihatname*”, që i ka botuar në anglishte me titullin “*Evliya Çelebi in Albania and Adjacent Regions (Kosovo, Montenegro, Ohrid)*”, Lajdën, 2000, kurse në gjuhën shqipe u botuan më 2008 me titullin “*Evlija Çelebi në Shqipëri dhe në viset fqinje*”. Në këtë vëllim janë përfshirë përshkrimet nga një pjesë e mirë e vëllimeve V-VIII të veprës në turqishte, siç thotë autori për herë të parë në bazë të dorëshkrimit autograf. Libri përmban *Parathënien* dhe tre kapituj: Pjesa I - *Nëpër Kosovë*, 1660; Pjesa II - *Nëpër Shqipërinë e Veriut dhe Malin e Zi*, 1662; Pjesa III - *Nëpër Shqipërinë Jugore*, 1670, si dhe nga *Fjalorthi, Faksimilet dhe Bibliografia*.

Shumica e shkrimeve të Robert Elsie-t kushtuar gjuhës shqipe janë shkrime që trajtojnë aspekte historike të shkrimit të saj, siç janë ndër të tjerat edhe këto: “*Teksti i Bellifortisit dhe shqipja e hershme*”, botuar së pari në gjuhën gjermane, “*Fjalorthi i Arnold Von Harfit*” dhe “*Fati i Gjon Buzukut*”. Në të tria këto shkrime, që kanë karakter paraqitës, njohës dhe kritik për publikun joshqiptar, e që janë përfshirë me pak a shumë ndryshime edhe në veprën e tij “*Historia e letërsisë shqipe*”<sup>42</sup>, mbështetur edhe në të dhënat e njohura të shkencës shqiptare dhe në dëshmi të gjetura nga hulumtimet e tij të gjera, shtrohen e problematizohen çështje të diskutueshme, për të cilat ai sjell hollësi plotësuese të faktuara.

Në shkrimin “*Teksti i Bellifortisit dhe shqipja e hershme*”, që është përfshirë edhe në *Historinë* e tij të letërsisë, Robert Elsie jep përmbledhtas historikun e dokumentuar të gjuhës shqipe, ndërsa në vëzhgim më të hollë shqyrton një tekst që ai e quan “tekst kureshtar” dhe që e konsideron si një “pikënisje për shkrimin shqip”. Fjala është për të ashtuquajturin “*Teksti i*

<sup>40</sup> R. Elsie, *Leksiku shqip i Evlija Çelebiut i vitit 1662 dhe ç’duhet të dijë dervishi shtegtar*, “Studime” 4, Prishtinë, 1997, f. 239-249.

<sup>41</sup> R. Elsie, *po aty*, f. 239-249.

<sup>42</sup> R. Elsie, *Historia e letërsisë shqipe*, “Dukagjini”, Pejë, 2001, f. 23-36.

*Bellifortis*”, që, sipas Elsie-t, ruhet në Muzeun Konde (Musée Condé), në Chato të Shantiji (Château de Chantilly), në veri të Parisit dhe mban datën 1405. Teksti përmban një shtojcë që ka 29 faqe dhe paraqitet si një “traktat i njohur mesjetar, në pjesën më të madhe në latinishte, mbi armët dhe fortifikimet ushtarake”<sup>43</sup>, nga pirotekniku gjerman Konrad Kyezer (Conrad Kyeser, 1366-1405), ndërkaq pjesa tjetër, që nuk lidhet fare me këtë pjesë të dorëshkrimit “*Bellifortis*”, është, si thuhet nga ai, një “tekst misterioz”, në të cilin janë përfshirë ritet e pagëzimit e ndër to edhe njëfarë ceremonie e pjekurisë gjinore. Teksti ka pjesë të paqarta që identifikohen si “namatisje e formula magjike me përsëritje dhe shndërrime fjalësh, pa dyshim për arsye tabush dhe kësisoj nuk janë menjëherë të përkthyeshme”<sup>44</sup>. Edhe vetë origjina e këtij teksti është misterioz sipas Elsie-t, i cili këtu përpiket t’u japë dorë supozimeve të veta se në ç’mënyrë ka përfunduar ky tekst brenda tekstit me karakter të dokumentit që lidhet me punimet xheniere e fortifikuese ushtarake. Me gjasë, sipas tij, gjatë vendosjes së sundimit anzhuin në Shqipëri, që zgjati pothuajse një shekull, deri në gjysmën e shekullit 14, e që njihet me valë ikjesh, ndër to edhe të disa katolikëve e klerikëve frëngj që kishin njëfarë njohje të shqipes dhe, pa dyshim, edhe folës të shqipes në Francën e shekullit 14 e 15, ku është ruajtur ky tekst.

Një shkrim tjetër për shqipen historike është “*Fjalorthi i Arnold Von Harfit*”, njëri ndër dokumentet e para të pakta shkrimore të shqipes së shekullit 15. Në këtë shkrim jo të gjatë, që i drejtohet në rend të parë lexuesit joshqiptar e në të cilin lihet mundësia për të shprehur se ekzistojnë më shumë tekste të tilla, Robert Elsie jep një përshkrim të hollësishëm rreth këtij fjalorthi me 26 fjalë, tetë shprehje, dymbëdhjetë numërorë dhe, natyrisht, sjell të dhëna jetëshkrimore të autorit të tij, – kalorës gjerman, udhëtar e shkrimtar, – i cili gjatë udhëtimeve të tij për në tokën e shenjtë, ka treguar interesim të vazhdueshëm edhe për gjuhët e zakonet e huaja. Këto fjalë e shprehje gjuhësore janë mbledhur gjatë ndalesës së tij në Portin e Durrësit në pranverën e vitit 1497 derisa po lundronte nga Venediku për në Aleksandri. Ndalesa si kjo e anijes së tij ka pasur edhe në Ulqin e Sazan. Raporti i tij nga këto udhëtime, sipas Elsie-t, ruhet në Ripuaria-n gjermane (Lugina e Rajnës).

Pos autor i këtij fjalorthi me fjalë të gjuhës shqipe, Arnold Von Harfi është autor edhe i disa fjalorthëve, të ashtuquajtur të xhepit, me fjalë e shprehje gjuhësore të kroatishtes, të greqishtes, të arabishtes, të hebraishtes, të turqishtes, të hungarishtes, të baskishtes dhe të bretonishtes. Si edhe në shkrimet e tjera, edhe në këtë shkrim, Robert Elsie sjell të dhëna plotësuese lidhur me dokumentet e para shkrimore të shqipes, – të dhëna të tjera të

<sup>43</sup> R. Elsie, *Fillimet e shkrimit shqip*, në *Historia e letërsisë shqipe*, “Dukagjini”, Pejë, 2001, f. 23.

<sup>44</sup> *Po aty*, f.24.

faktuara me referenca të rëndësishme bibliografike rreth grafisë, por sidomos rreth historisë së këtij dorëshkrimi.

Robert Elsie ka botuar edhe një shkrim kushtuar autorit të librit të parë shqip me titullin “*Fati i Gjon Buzukut*”, në të cilin, pos përshkrimit ta quajmë “të jashtëm” të “*Mesharit*”, ai shtron: 1. Teza e hipoteza lidhur me vendin e botimit të tij, në Venedik, mendim ky i shumicës së studiuesve të këtij libri; pastaj në Mal të Zi – Obod më 1483 i quajtur më vonë Cetinje; në Graçanicë të Kosovës; në Shkodër, – qytete këto në të cilat dëshmohej se asokohe ekzistonin shtypshkronja dhe botoheshin libra fetarë; 2. teza e hipoteza lidhur me alfabetin me të cilin u botua “*Meshari*”, përbërja e shkronjave të të cilit, sipas Elsie, i jep dorë atij që të mendojë se “Buzuku dhe ose punëtorët e shtypshkronjës së tij duhet të kenë pasur kontakt me serbo-kroatishten, sidomos me sistemin e shkrimit *Bukvica* që përdorej në Bosnjë”<sup>45</sup>; 3. teza e hipoteza lidhur me llojin e shkronjave dhe ngjashmërinë e tyre me ato që përdorëshin në Venedik më 1523 dhe 1537, ku ishin botuar mesharë në alfabetin cirilik për katolikët e Bosnjës, duke u mbështetur në mendimin e Mario Rokut, i cili, sipas Elsie-t, thotë se “Buzuku kishte huajtur nga sllavët katolikë të Bosnjës, të Dalmacisë dhe të Serbisë jo vetëm shkronjat cirilike dhe tipografinë venedikase, por ndoshta edhe vetë idenë që t’u jepte bashkëvendësve një meshar në gjuhën e tyre”<sup>46</sup>.

Këto edhe të tjera dëshmi, si ajo e ngjashmërisë përmbajtjesore të “*Mesharit*” të Gjon Buzukut me një meshar boshnjak të botuar më 1512, e çojnë autorin te supozimi se këto fakte mund të dëshmojnë diçka më shumë për Buzukun dhe “*Mesharin*” e tij. Nga kjo anë, mendimi i Robert Elsie-t për prejardhjen e Gjon Buzukut pajtohet me mendimin e disa të tjerëve, sipas të cilëve pikërisht tiparet e gegërishtes veriperëndimore të këtij *Meshari* lejojnë të supozohet që ai duhet të jetë nga ndonjëri prej fshatrave përreth bregut perëndimor të Liqenit të Shkodrës, afër Shestanit, sot në Mal të Zi, por që ai vetë “nuk ka jetuar brenda Shqipërisë, por diku në Adriatikon Verior, në Republikën e San Markos, ndoshta në vetë rajonin e Venedikut, ku ishin vendosur familje refugjatësh shqiptarë pas pushtimit turk të Shkodrës më 1479”<sup>47</sup> dhe se në Venedik “duhet të ketë pasur më shumë mundësi të shkollohet dhe të përgatitet si prift, sesa në Shqipëri”<sup>48</sup>.

Robert Elsie shtron edhe dilema të tjera që lidhen me mbijetesën shekullore të vetëm një kopjeje të “*Mesharit*” deri në zbulimin e tij më 1743, si dhe me rrugëtimin e tij të mëtejme deri në shekullin 20. Me interes e gjej mendimin e tij se mbijetesë e vetëm një kopjeje të “*Mesharit*” dhe mungesa e librave shqip në shekullin 16 duhet të lidhen me historinë e Kishës katolike dhe

<sup>45</sup> R. Elsie, *Fati i Gjon Buzukut*, gazeta, “Shekulli”, Tiranë, 14 .6.2006, f. 18-19.

<sup>46</sup> *Po aty*, f. 18-19.

<sup>47</sup> R. Elsie, *po aty*, f. 18-19.

<sup>48</sup> *Po aty*, f. 18-19.

me politikat e asokohshme për botimet, sidomos për botimet në gjuhët vendëse, që pësuan luhataje të mëdha gjatë viteve të Këshillit të Trentit (1545-1563), me fundin e Rilindjes në Itali, me atmosferën e përgjithshme të frikës dhe të kërcënimit që sundonte gjatë Inkuizicionit, kur shumë libra që u lejuan të botoheshin përgjatë gjysmës së dytë të shekullit 16, me dekrete të veçanta nga Zyra e Shenjtë e që u futën në Indeks të librave të ndaluar, kur “pesëdhjetë e shtatë njerëz të librave u thirrën të paraqiteshin te Zyra e Shenjtë më 22 gusht 1558<sup>49</sup> dhe kur u shpall njoftimi për ndalimin e botimit të Biblës në gjuhët vendëse.

Brenda kësaj trajtесе rreth kontributit të Robert Elsie-t për gjuhësinë shqiptare, vlen të thuhet edhe pak fjalë lidhur me një shkrim tjetër të tij me karakter zbulues për gjuhën shqipe. Fjala është për shkrimin e titulluar “*Zëri i parë shqip – Mbi incizimin e parë të gjuhës shqipe*” nga Norbert Jokli<sup>50</sup>, në të cilin ai na sjell zbulimin e tij të incizimit të parë të shqipes së folur. Ky zbulim është dëshmi e rëndësishme historike për albanologjinë. Incizimi i zbuluar konsiderohet deri tash më i vjetri, ruhet në Arkivin e Austrisë dhe mban datën 1914. Në këtë shkrim Robert Elsie jep të dhëna për motivet e realizimit të këtij incizimi nga ana e Norbert Joklit, për kontekstin e realizimit, subjektin folës dhe për dëshmi të tjera të rëndësishme rreth tij.

Po kështu, me këtë rast e quaj të rëndësishëm vlerësimin për faqen e tij zyrtare të internetit, në të cilën Robert Elsie, derisa ka mbyllur sytë, ka publikuar materiale të rëndësishme, të shumta e të larmishme, pos për letërsinë, historinë e kulturën shqiptare në përgjithësi, edhe për gjuhën shqipe, si tekste, vështrime, kritika, intervista, referenca shkencore, – të gjitha këto të paraqitura e të strukturuar në mënyrë shumë profesionale, në gjuhët shqipe, angleze dhe gjermane. E konsideroj më të çmueshmen në këtë platformë digjitale faqen kushtuar gjuhës shqipe<sup>51</sup>, e cila është e ndarë në tri njësi, kurse këtu na interesojnë dy të parat: *Gjuha shqipe*, në të cilën përshkruhet gjuha e sotme shqipe nga aspekti përmbajtësor e strukturor, nga aspekti historik (prejardhja dhe zhvillimi i saj) dhe nga aspekti gjeografik (shtrirja e saj – ku flitet krejt ajo etj.); *Dialektet*, në të cilën jepen të dhëna shkencore për dy dialektet e nëndialektet e shqipes, si dhe të folmet kalimtare; brenda kësaj faqeje më i rëndësishmi mendoj se është projekti i tij i fundit, – studimi për larmitë gjuhësore të gjuhës shqipe, përkatësisht për variantet e saj, me të cilin projekt dokumenton shqipen e folur të kohës sonë, të konkretizuar përmes 147 incizimeve zanore të realizuara: në Shqipëri 75 incizime zanore, në Kosovë 34,

<sup>49</sup> *Po aty*, f. 18-19.

<sup>50</sup> *Zëri i parë shqip. Mbi incizimin e parë të gjuhës shqipe nga Norbert Jokli*, Seminar i Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare 19, Prishtinë, 2001, f. 377-382.

<sup>51</sup> R. Elsie: [www.elsie.de](http://www.elsie.de)

në Maqedoni 26 dhe në Mal të Zi 12 incizime, por edhe jashtë trojeve shqiptare, në shtete ku jetojnë shqiptarë, si në Itali, Bullgari, Turqi, Greqi, Kroaci, Ukrainë<sup>52</sup> etj., që publikohen në këtë uebsajt. Incizimet janë kryer në rrethin kohor 2008-2009.

Kjo lëndë gjuhësore e incizuar mund të shfrytëzohet me lehtësi në saje të hartave të paraqitura për të gjitha trojet ku flitet shqip dhe nga ku janë marrë subjektet që mund të dëgjohen me një klikim në pikën gjuhësore që na intereson. Hartat shoqërohen edhe me të dhëna të plota për subjektet folëse, identitetin, moshën, zonën, dialektin, fenë e të dhëna të tjera për ta. Si i tillë ky projekt, i shfrytëzueshëm prej gjithsecilit prej nesh e në mënyrë fare të lehtë, pa dyshim se ka rëndësi të madhe jo vetëm për dialektologët, por edhe për studiues të tjerë të interesuar për gjuhën shqipe. Ky projekt në të vërtetë dokumenton dhe përjetëson variantet dialektore të regjistruara nga Robert Elsie.

Kontributet e fundit me interes për historikun e shkrimit të shqipes të Robert Elsie-t janë veprat “*Early Albanian Bible Translations in Todhri Script*”<sup>53</sup> dhe “*Alfabetet shqipe: të huazuar dhe të krijuar*”<sup>54</sup>, të botuara e para më 2016 dhe e dyta më 2017, pak muaj para se të vdiste. Në veprën e parë “*Përkthimet e hershme shqipe të Biblës në dorëshkrimet e Todhrit*”, të botuar në gjuhën angleze, ai rihap çështjen e përkthimeve më të hershme të Biblës në gjuhën shqipe, me theks të veçantë në përpjekjen në këtë drejtim të Dhaskal Todhrit (1730-1805). Është kjo çështje me të cilën ai është marrë edhe në shkrimet e tij të mëhershme rreth historikut të shkrimit të shqipes. Ky libër në të vërtetë shtron teza e hipoteza të reja me qëllim që të dritësojë të dhëna e dëshmi që kanë mbetur të pandriçuara mjaftueshëm në studimet e deritashme për periudhën e shkrimeve të traditës ortodokse të gjysmës së dytë të shekullit 18 dhe gjysmës së parë të shekullit 19, ose çështje që vazhdojnë të trajtohen me hamendësime lidhur me tezën e Georg fon Hanit, po edhe të studiuesve të tjerë, se pikërisht Todhri është përkthyesi jo vetëm i *Dhiatës së Vjetër*, por edhe i *Dhiatës së Re*, por edhe i veprave të tjera fetare. Mbetja pezull e tezës së Hanit lidhur me autorësinë e Todhrit si përkthyesi më i hershëm i Biblës në gjuhën shqipe, për faktin se pjesa më e madhe e shkrimeve të të cilit janë djegur më 1827 si rrjedhojë e një epidemie, e ka grishur studiuesin Robert Elsie të “gërmojë” në arkivat e ndryshëm e në dosjet e albanologëve të huaj që janë

<sup>52</sup> R. Elsie, *Shqipëria dhe shqiptarët*, intervistë me Anisa Ymerin, në *News 24*, Tiranë, 1.4.2016.

<sup>53</sup> R. Elsie, *Early Albanian Bible Translations in Todhri Script (Përkthimet e hershme shqipe të Biblës në dorëshkrimet e Todhrit)*, Albanian Studies, Vol. 30 Centre for Albanian Studies, London 2016, 162 pp.

<sup>54</sup> R. Elsie, *Albanian Alphabets: Borrowed and Invented*, “Albanian Studies”, Vol. 35, Centre for Albanian Studies, London, 2017, 117 pp.

marrë me këtë çështje për të nxjerrë fakte të reja e për të shtruar edhe teza e hipoteza të reja. Libri sjell shumë informacione e referenca bibliografike dhe ka karakter kritik e zbulues.

Libri tjetër i titulluar “*Alfabetet shqipe: të huazuar dhe të krijuar*” jep historikun e alfabeve të shqipes të periudhës 1750-1850. Sipas Robert Elsie-t, para Kongresit të Manastirit, ku u vendos përfundimisht çështja e alfabetit të shqipes, gjuha shqipe është shkruar në më shumë se dhjetë alfabete, kryesisht alfabete të adaptuara nga ato latine, greke, arabe e cirilike. Sipas tij, kjo periudhë e shkrimit të shqipes konsiderohet shumë e pasur dhe shquhet për përpjekje të mëdha të intelektualëve shqiptarë për një alfabet të përbashkët. Fryt i këtyre përpjekjeve janë edhe disa alfabete origjinale, ndër të cilët si më të njohurit përmend alfabetin me të cilën u shkrua “*Dorëshkrimi Elbasanas i Ungjijve*”, alfabetin e Teodor Haxhifilipit nga Elbasani, të quajtur edhe alfabeti i Dhaskal Todhrit dhe, ndër më kryesorët, atë të Naum Veqilharxhit. Kjo vepër e Robert Elsie-t është kontribut i dhënë drejtpërdrejt historikut të shkrimit të shqipes në një periudhë të ndriçuar pak.

Edhe në fushën e leksikografisë tematike kemi një kontribut të Robert Elsie-t të materializuar me “*Fjalor i fesë, i mitologjisë dhe i kulturës popullore*”<sup>55</sup>, në anglishte e gjermanishte, dhe me “*Leksikun e kulturës popullore shqiptare*”<sup>56</sup>, në gjuhën shqipe, që paraqet interes, pos për fushën e antropologjisë dhe të etnologjisë shqiptare, edhe për leksikografinë shqipe. Baza e këtij fjalori tematik, si e thotë vetë autori në *Parathënien* e tij, janë besimet, përfshirë këtu figurat e mitologjisë shqiptare, festat kalendarike, ritualet e besëtytnitë popullore, doket e zakonet popullore, etnografia popullore, deri edhe doket gjinore, gjakmarrja dhe institucionet e së drejtës dokesore shqiptare. Thënë shkurt: në këta fjalorë paraqitet një pasuri gjuhësore, etnografike, mitologjike, filozofike, folklorike e antropologjike. Sa i përket kësaj pasurie, për Robert Elsie-n Shqipëria është një “muze i gjallë i së kaluarës”<sup>57</sup>. Fjalori jep një numër të madh informacionesh të njohura e të panjohura për lexuesin shqiptar e joshqiptar dhe është i pajisur me të dhëna të shumta e të hollësishme bibliografike.

Në kontekstin e asaj që u tha deri këtu dhe duke marrë parasysh tematikën e këtyre trajtesave gjuhësore, karakterin e akribinë shkencore, mund të bëhet një përcaktim i përafërt se cili është kontributi i Robert Elsie-t në

<sup>55</sup> *Dictionary of Albanian Religion, Mythology and Folk Culture (Fjalor i fesë, mitologjisë dhe kulturës popullore shqiptare)*, Londër, 2001; Nju Jork, 2001; u botua edhe në gjermanisht *Handbuch zur albanischen Volkskultur*, Wiesbaden, 2002.

<sup>56</sup> *Leksiku i kulturës popullore shqiptare* (shqipëroi Abdurrahim Myftiu), “Skanderbeg Books”, f. 2005, Tiranë, f. 282 .

<sup>57</sup> *Po aty, Parathënia* e Robert Elsie-t, f. 8.

fushën e studimeve gjuhësore. Ja çka krejt e përbën atë kontribut të tij studimor:

1. Zbulim dhe aktualizim i gjetjeve të tij të reja për të dokumentuar lashtësinë e gjuhës shqipe, historinë e shkrimit shqip dhe të alfabetëve të tij, gjithnjë të vështruara në raport me kontekstin kohor e hapësinor, natyrisht fryt ky i ngulmimit të tij për të gjurmuar nëpër arkivat e shteteve evropiane e më gjerë, sidomos në dosjet e albanologëve më të mëdhenj shqiptarë, që janë marrë me shqipen dhe me historinë e saj;

2. rivështrim, shpesh edhe plotësim e riinterpretim i studimeve të albanologëve vendës e të huaj për të dhëna e dukuri të shqipes. Jo rrallë Robert Elsie e ka zbuluar arsyen dhe qëllimin e këtyre shkrimeve të tij: “Mua më intrigon mënyra e saktë sesi të huajt e kanë studiuar Shqipërinë”<sup>58</sup>, thoshte ai;

3. rimarrje e rivështrim i dokumenteve të para të gjuhës shqipe e i veprës së Buzukut dhe në këtë kontekst më e rëndësishmja që spikat është përpjekja e tij për ta lëvizur kufirin më tej të shkrimit të shqipes, së paku tre shekuj para tyre, duke sjellë të dhëna të reja të shekujve 11, 13, 14, të cilat, sipas tij, dëshmojnë kohën se “kur hyjnë shqiptarët në skenë të historisë së shkruar pasklasike”<sup>59</sup>;

4. vështrim e vëzhgim mbi gjuhën shqipe, historinë e të sotmen e saj, si dhe klasifikim e regjistrim zanor i të folmeve shqipe nga një areal i gjerë gjeografik-gjuhësor.

Pavarësisht se në këto trajtime e vëzhgime për gjuhën shqipe mund të gjenden edhe çështje të diskutueshme nga ana shkencore, çështje të cilat nuk janë argumentuar mjaftueshëm, çështje për të cilat gjuhësia shqiptare tashmë ka dhënë përgjigje meritore shkencore ose, më në fund, edhe mendime me të cilat ose pajtohem vështirë ose nuk na mbushin mendjen mjaftueshëm, ato janë kontribut i vlefshëm për albanologjinë gjuhësore.

Robert Elsie jo me shumë dëshirë ka biseduar me gazetarë, megjithëse numri i intervistave të tij dhënë gazetarëve të shumtë në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e gjetiu sillet rreth 50 sosh. Në intervistat e tij, në të shumtën e rasteve të zhvilluara me shkas, me rastin e botimit të veprave të tij të shumta origjinale ose të përkthyer, nga gazetarët nuk janë shmangur edhe pyetje që lidhen me shqipen e sotme standarde, me vlefshmërinë e standardit të saj, me debatet kundërshtuese të zhvilluara në tre dhjetëvjetëshat e fundit në Kosovë e Shqipëri e më gjerë. Kurdoherë ai ka mbajtur qëndrimin që pritet gjithmonë prej një të huaji, që është dëshmuar me punën e tij si dashamirës i madh i pasurisë shpirtërore e kulturore të shqiptarëve. Kështu, në një intervistë

<sup>58</sup> Intervistë, *Robert Elsie: Lef Nosi s'e kishte të dashur Margaret Hasluck*, zhvilluar me Dhurata Hamzain, gazeta Shqiptarja.com, Tiranë, 12, 11. 2015.

<sup>59</sup> R. Elsie, *Një vjedhje në Dubrovnik dhe dalja në skenë e gjuhës dhe e kulturës shqiptare*, “Përpjekja” 6, Tiranë, 1996, f. 88-92.

televizive të zhvilluar më 2014<sup>60</sup>, pyetjes së gazetares se ç' mendim kishte për përplasjet e pikëpamjeve lidhur me rishikimin e Kongresit të Drejtshkrimit, ai i përgjigjet: “Kjo është punë e shqiptarëve që të vendosin për gjuhën e tyre. Kuptoj që zhvillimi historik ka çuar që toskërishtja të sundonte pak më shumë në një kohë kur shumica ishin gegë dhe kjo krijon sot një problem, por gjithsesi gjuha standarde ekziston dhe duhet për një komunikim të përbashkët, por në fund është puna e shqiptarëve që të vendosin se si ta konkretizojnë këtë gjuhë”<sup>61</sup>. Ndërkaq, në një intervistë tjetër për BBC-në e Londrës, në pyetjen e ngjashme të gazetarit, ai do të përgjigjet: “Edhe këtu besoj që shqiptarët ndoshta janë tepër të ndjeshëm dhe nuk kuptoj arsyet për sensitivitetin e tyre. Sepse gjuha letrare ekziston, pranohet nga të gjithë shqiptarët, pranohet nga e gjithë bota si gjuhë zyrtare e shqiptarëve. Është mjeti më i pranueshëm i komunikimit midis shqiptarëve, dhe nuk hidhet poshtë. Por ka hapësirë edhe për variantet e tjera, në fushën e letërsisë patjetër”<sup>62</sup>. Edhe në një intervistë tjetër të zhvilluar më 2016<sup>63</sup>, në një pyetje po për vlefshmërinë e gjuhës standarde shqipe dhe kontestimet e atykëtushme, sidomos në mediet, ai përgjigjet njëjtë: “Më pyesin shpesh për këtë gjë, por unë s’kam mendim. Mendoj se është punë e shqiptarëve të vendosin për gjuhën e tyre”, për të vazhduar më tej: “Si përdorues kam mësuar gjuhën letrare, kam mësuar të kuptoj edhe gegnisht dhe variante të ndryshme... por të tjerat janë çështje e shqiptarëve, nëse krijohet një variant i dytë gegnisht, si standard i dytë. Natyrisht më duhet të them se ka një avantazh të ketë një gjuhë të përbashkët për të gjithë, që respektohet nga të gjithë për shkrimin, për televizionin, për mediat. Është më lehtë kështu. Por e kuptoj që shumë njerëz, shumë gegë janë të pakënaqur sepse gjuha e tyre është shumë larg standardit dhe e kanë të vështirë të shkruajnë në standard dhe të komunikojnë; të detyrohen të komunikojnë në shqipen standarde. Këtë e kuptoj shumë mirë. ... E kuptoj por s’di nëse është një zgjidhje krijimi i një standardi tjetër nga ky që keni. P.sh. të krijohet një standard gegë në Kosovë, nuk besoj që u hyn në punë shqiptarëve!”<sup>64</sup>.

<sup>60</sup> Robert Elsie – *Shqipëria dhe Kosova*, intervistë e zhvilluar me Rudina Xhungën për televizionin Top Channel, Tiranë, shkurt 2014; botuar me titullin Robert Elsie në një rrëfim të bukur, me rastin e vdekjes së tij në Dritare.net më 23 prill në Ditën Ndërkombëtare të Librit.

<sup>61</sup> *Po aty*.

<sup>62</sup> Intervistë për BBC-në, Londër, Redaksia shqipe, botuar në gazetën “Java”, Prishtinë, 29.5.2003; intervistoi Ragip Luta.

<sup>63</sup> Intervistë e zhvilluar e Robert Elsie-t me Anisa Ymerin për emisionin “Tempull”, të televizionit News 24, Tiranë, prill 2016; Intervista u botua në gazetën “Tema” me titullin *Shqiptarët nuk kanë ende një histori, por vetëm parulla*, 6.4.2016.

<sup>64</sup> *Po aty*.

Ky mendim i tij, i shprehur aq herë sa është pyetur për këtë çështje, pa dyshim i drejtë, më në fund përkrahës për gjuhën standarde, tregon se ai ka qenë i ndërgjegjshëm se çështjet madhore, siç është edhe ajo e një gjuhe të përbashkët për një popull historik siç janë shqiptarët, për një popull të qytetëruar, është plotësisht çështje që u takon atyre. Dhe ata, pra shqiptarët, këtu e 45 vjet më parë e kanë thënë *Po*-në e tyre të madhe për një gjuhë të përbashkët për të gjithë shqiptarët kudo janë. I kanë thënë *Po* gjuhës standarde shqipe dhe të ardhmes së tyre gjuhësore dhe kombëtare.

Po e përmbyll këtë shkrim gjithsesi të shkurtër për kontributin e Robert Elsie-t dhënë gjuhës shqipe e ndërgjegjshme se kontributi i tij është shumë më i madh se kaq sa u tha. Robert Elsie i deshi shqiptarët dhe tokën e tyre, i deshi gjuhën e historinë e tyre, i deshi të shkruarën e të pashkruarën për ta, i deshi këngën e vajin e tyre, i deshi ndershmërinë e ashpërsinë e tyre. Për ta la pasuri të madhe e të çmueshme kulturore, vlera e kuptimi i së cilës do të shumëfishohen nëpër kohë. Jam e bindur se ai ka marrë më vete edhe shumë nga ato që kish për të na i dhënë e për të na i thënë. Albanologjia është varfëruar pa një studiues të mençur, të ditur e të përkorë dhe pa një dashamirës fisnik e të rrallë të gjuhës shqipe e të folësve të saj.

## SUMMARY

### ROBERT ELSIE AND ALBANIAN LANGUAGE

Robert Elsie, an eminent Albanologist of our days, has left behind a rich scientific and cultural creativity. This is best evidenced by his works published in Albanian, but most of them in foreign languages, first of all in English. This is testified by a large number of studies, treatments, observations and articles published on various issues related to Albanian language, its written and oral literature, ethnography, anthropology and mythology.

This writing in an analytical and synthetic way represents the contribution of Robert Elsie given to the Albanian language, respectively to its history and present. This is how the following works by Robert Elsie are considered: Early Albanian translations of the Bible in Todhri's manuscripts; Albanian alphabets: borrowed and created; Dictionary of Albanian folk culture; then studies and treatises: The Elbasan Manuscript of the Gospels 1761 and the struggle for the creation of an Albanian alphabet; Albanian literature in Greek manuscripts: Orthodox tradition in the eighteenth century and early nineteenth century in Albanian writings; A robbery in Dubrovnik and the emergence of the Albanian language and culture; Early data on the existence of the Albanian language; Evliya Çelebi's Albanian Dictionary of 1662 and what the nomadic dervish should know; Belfortortis text and early Albanian; Arnold Von Harf's

---

Dictionary 1497; The Fate of Gjon Buzuku; “The First Albanian Voice - On the First Recording of the Albanian Language”; as well as its digital platform called Albanian Language. At the end of this article, Robert Elsie's attitudes towards the standard language, which are shown in his numerous interviews, are presented.

At the end of this article, I can conclude that Elsie's contribution to Albanian language can be summarized in the following points: 1. discovery and actualization of his new findings to document the antiquity of the Albanian language, the history of Albanian writing and its alphabets, always observed in relation to the temporal and spatial context, and 2. revisiting, often supplementing and reinterpreting the studies of local and foreign Albanologists for data and phenomena of Albanian language.

